

Prova të shtimit të disa nënshartesave të reja që shtohen në laboratorin “in vitro”



Studim

Titulli: **Prova të shtimit të disa nënshartesave të reja që shtohen në laboratorin “in vitro” (viti i dytë i studimit) 2017-2018.**

Punoi: E. papakosta; Email: elektrakrist@yahoo.com

Kultivimi dhe shtimi i kulturave drufrutore me qëllim përdorimin e materialit mbjellës të pastër duke ruajtur saktësinë gjenetike dhe gjendjen fitosanitare, zbatimi i teknologjive inovative e bashkëkohore në shtimin *in vitro* të kultivarëve autoktonë dhe të huaj drufrutorë, me qëllim përfitim të një produkti të pastër në aspektin fitosanitar si dhe rigjenerimin e koleksioneve autoktone drufrutore me material bimor të kontrolluar me rëndësi prioritare për zhvillimin cilësor të frutikulturës shqiptare.

Objektivi 1. Krijimi i germoplazmës së nënshartesave të pemëve frutore (GF-677, mirabolano 29/C, dardhë OHxF 333, qershi- Gisela 6)

Rezultate të pritshme:

Rezultati 1.1

- Shtimi *in vitro* i materialit bimor në kulturat drufrutore bërthamorë (nënshartesa drufrutore):

1. Pjeshkë: GF-677 (*Prunus persica* x *Prunus amygdalus*);
2. Mirabolano 29/C (*Prunus cerasifera*);
3. Qershi- Gisela 5 (*Prunus cerasus* × *P. canescens*); Cab 6

Rezultati 1.2

- Aklimatizimi *in vivo* i nënshartesave të kulturave drufrutore: pjeshkë: GF-677, mirabolano 29/C, dardhë OHxF 333, qershi- Gisela 5 dhe Cab 6 me anë teknikës *in vitro*.

- Krijimi i germoplazmës të nënshartesave drufrutore bërthamore.

Aktivitetet kryesore të Objektivit 1.

Aktiviteti 1.1


- Evidentimi dhe marrja e materialit bimor në drufrutorë bërthamorë (nënshartesa: pjeshkë: GF-677, mirabolano 29/C, dardhë OHxF 333, qershi- (Gisela 5; Cab 6) për shtimin *in vitro*. (mini screen house bimë “mëmë” të nënshartesave drufrutore bërthamore – Baza Shamogjin.

Prova të shtimit të disa nënshartesave të reja që shtohen në laboratorin “in vitro”

Në muajt maj- prill u mor materiali bimor eksplantë (sythe apikalë dhe anësorë) për kultivimin dhe shtimin *in vitro*

Aktiviteti 1.2

Inokulimi në kulturë *in vitro* i materialit bimor duke zbatuar protokollet shkencore specifike për çdo specie drufrutore. (Terrene MS, MS/2, WPM)





Figurë 1. Inokulimi i eksplantëve drufrutore në boksen laminar

Aktiviteti 1.3

Shtimi me mikroshumim *in vitro* i nënshartesave të kulturave drufrutore bërthamore:

- nënshartesa: pjeshkë GF-677 (*Prunus persica* x *Prunus amygdalus*);
- mirabolano 29/C (*Prunus cerasifera*);
- qershi- Gisela 5 (*Prunus cerasus* × *P. canescens*); Cab 6



Prova të shtimit të disa nënshartesave të reja që shtohen në laboratorin “in vitro”



Figurë 2. Mikroshumimi dhe ambientimi i kulturave drufrutore

Aktiviteti 1.4

Aklimatizimi *in vivo* në miniserrë i bimëve të shtuara *in vitro* (bimë të rrënjëzuara *in vitro*: qershia Gisela 5, Cab 6, mollë, shegë) (muaji - prill)



Figurë 4. Ambientimi *in vivo* i kulturave drufrutore

Rekomandime:

- Nënshartesat drufrutore bërthamore: pjeshkë (GF-677); kumbull: mirabolano (29/C), sidomos nënshartesat e qershisë (Gisela 5: Cab 6), të kërkuara nga fermerët, kultivohen dhe shtohen me sukses në kulturë *in vitro* me prioritet në shtim dhe rezultojnë të pastra nga viruse në aspektin gjenetik dhe fitosanitar.